



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

### Njoftim Për Shtyp

**Rasti:** Krijimi i sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies LTD dhe Champion Motors LTD

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën Nr. 268 Prot., protokoll i AK, datë 15.04.2018 “Përqendrimi ndërmjet Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies LTD dhe Champion Motors LTD”, përfaqësuesi ligjor CR Partners SHPK ka njoftuar në lidhje me krijimin e sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA me Mobileye Vision Technologies LTD dhe Champion Motors LTD.

Palet në transkasion janë:

**Volkswagen Financial Luksemburg SA (VWFL)**, është një shoqëri e themeluar sipas legjisllacionit të Luksemburgut,

VWFL është filial e grupit Volkswagen AG i cili është aktive në të gjithë botën nëpërmjet zhvillimit, tregtimit, prodhimit dhe shitjes së automjeteve.

**Shqipëri:** Grupi Volkswagen është aktiv në Shqipëri nëpërmjet pjesëve kryesore të biznesit të tij, shitjen dhe shpërndarjen e automjeteve motorike, duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesore të tjerë, motorët më naftë dhe motoçikleta.

Grupi Volkswagen ka tre entitete të themeluara në Shqipëri: Porsche Leasing SHPK; Porsche Mobility SHPK, Porsche Albania SHPK.

**Mobileye Vision Technologies LTD** është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Izraelit dhe është aktive në zhvillimin e vizioneve kompjuterike, të mësimin të drejtimit të makinës, analizimit të të dhënave, vendndodhjen në harta digitale të automjeteve me qëllim asistencën teknike për drejtuesit.

Shoqëria është e kontrolluar tërësisht nga Intel Corporation (Intel)

**Champion Motors** është shoqëri izrealite, distributor i drejtpërdrejtë i markës Volkswagen, Skoda, Audi dhe Seat në Izrael.

Champion Motors zotërohet tërësisht nga Allied Holding Ltd, e cila është shoqëria mëmë izrealite që vepron në industrinë e elektronikës, infrastrukturës dhe atë të automjeteve.

Në datën 08.04.2019 është nënshkruar “Marrëveshja Joint Venture” midis shoqërive Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies LTD dhe Champion Motors LTD e cila ka për qëllim krijimin e një sipërmarrje të përbashkët (JV) me funksione të plota, e cila do të veprojë vetëm në Izrael në shërbimin e transportit të automjeteve vetëlëvizëse. Shoqëria do të kontrollohet në mënyre të njëjtë nga të tre palët në marrëveshje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**